



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 10.02.2026

Numër Protokolli: 746/2026

A.nr.4/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Ilire Mehmeti Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.4/2026, të datës 06.01.2026, të parashtruar nga ankuesja F.G, kundër organit të punësimit/Shërbimi Sprovues i Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Adminsitrativ i nisuar sipas numër A.nr.04/2026, e datës 06.01.2026, e parashtruar nga ankuesja F.G.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil F.G (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), më datë 06.01.2026, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 06.01.2026 nën shenjën A.nr.4/2026, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00018972, për Grupin e shkencave shoqërore, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar Sprovues, i shpallur nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.4/2026, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Shërbimi Sprovues i Kosovës, më datë 27.10.2025, ka shpallë konkursin me numër reference RN00018927, për Grupin e shkencave shoqërore, gjegjësisht për pozitën e punës Zyrtar Sprovues, me klasë të pozitës Profesional 2, dy (2) vend pune, i hapur për aplikim nga data 28.10.2025 deri më datë 26.11.2025.

Tutje sipas provave të lëndës, rezulton se ankuesja, pas përfundimit të procesit, rezulton se lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00018927, më datë 26.12.2025 Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Sprovues të Kosovës, ka publikuar rezultatet përfundimtare kur rezulton se kandidatja fituese A.M ka marrë 81.2 pikë.

Ankuesja më datë 06.01.2026 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 10.12.2025 për refuzimin e aplikacionit me arsyetimin se ankuesja nuk ka bashkangjitur dëshmi mbi përvojën e punës pas diplomimit.

Duke qenë se kandidatja S.G-S, si kandidate aplikues në procedurën e rekrutimit konkursit me Nr. Reference: RN00018927, për Grupin e shkencave shoqërore, gjegjësisht për pozitën e punës Zyrtar Sprovues, me klasë të pozitës Profesional 2, dy (2) vend pune, i hapur për aplikim nga data 28.10.2025 deri më datë 26.11.2025, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A.nr.2085/2025, të datës 06.02.2026, kishte aprovuar në tërësi ankesën e ankuses, duke **Anuluar** Njoftimi i datës 26.12.2025, i Divizionit për Burime Njerëzore të Shërbimit Sprovues të Kosovës, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare në procedurën e pranimit më numër Reference: RN00018927, pozita Zyrtar Sprovues si dhe të gjitha veprimet administrative të ndërmarra në fazën e verifikimit paraprak dhe fazën e vlerësimit profesional, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim të aplikacioneve të kandidateve aplikues në këtë procedurë.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.4/2025, të datës 06.01.2026, ka të bëjë me procedurat e pranimit për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.2085/2025, të datës 06.02.2026, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi këto procedura, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.4/2026, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.4/2025, të datës 06.01.2026.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.4/2026

Ilire Mehmeti Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses F.G;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Sprovues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;